



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER BLERINA I. MUSTAFARAJ
ADRESA Bulevardi "Shqipëria", Pallati
Agimi, Hyrja 17, Ap. 308
TEL: 694036964

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 99

Nr. koleksioni: 19

Tirane më 09/03/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

***Akti noterial përbëhet nga 20 fletë**



A2021051080003510760



A2021051080003510760

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SPV BLUE 1 SH.P.K.
SUBJEKT PËR QËLLIME TË VEÇANTA(SPV)**

Në bazë të Ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit", u vendos si më poshtë vijon:

**KAPITULLI I
THEMELIMI, EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI**

Neni 1 – Data e Themelimit dhe Emërtimi i Shoqërisë

1.1 Sot, më datë 09.03.2021, palët e mëposhtme:

-Shoqëria **"Blessed Investment" Sh.p.k.**, një shoqëri e së drejtës shqiptare, e pajisur me NUIS L71423028S dhe me seli në adresën: Rruga Themistokli Gërmenji, kati I, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori, Znj. Ana Lleshi;

-Shoqëria **"Matrix Konstruksion" Sh.p.k.**, një shoqëri e së drejtës shqiptare, e pajisur me NUIS J91306009Q dhe me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr.18/2 Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori, Znj. Ida Mezini;

nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi dhe Statuti kanë vendosur të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar *SPV Blue 1 sh.p.k.* (këtej e tutje referuar edhe si "Shoqëria"). Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

1.2 Shoqëria e krijuar ka emërtimin **SPV Blue 1 sh.p.k.**

1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Selia

2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga "Themistokli Gërmenji", Nr. 6, Kati 1, Tiranë, Shqipëri.

2.1 Shoqëria mund të hapë dhe/apo mbyllë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri dhe/apo jashtë saj.

2.2 Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: analleshi@abkons.com.

Neni 3 – Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i Aktivitetit

4.1 Shoqëria do të ketë për objekt kryesor aktiviteti ndërtimin, mirëmbajtjen dhe operimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse për projektin "Blue 1", në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, tregtimin e energjisë elektrike që do të prodhohet nga centrali gjenerues, si dhe çdo veprimtari tjetër në funksion të realizimit të projektit. Për arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryej çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të



A2021051080003510760

paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, ligjor, që lidhet direkt ose indirekt, me objektin e mësipërm dhe që mund të konsiderohet i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet aktiviteti i Shoqërisë.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, RITJA DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1,000,000 (një milion) Lekë, i përbërë nga 100 (njëqind) kuota. Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si më poshtë vijon:
- Shoqëria Blessed Investment Sh.p.k. ka kontribuar në para në kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 510,000 (pesëqind e dhjetë mijë) Lekë, shumë e cila është paguar;
 - Shoqëria Matrix Konstruksion Sh.p.k. ka kontribuar në para në kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 490,000 (katërqind e nëntëdhjetë mijë) Lekë, shumë e cila është paguar.
- 5.2 Në bazë të kontributeve të sipërcituara:
- Shoqëria Blessed Investment Sh.p.k. zotëron 51 (pesëdhjetë e një) kuota, e barabartë me 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
 - Shoqëria Matrix Konstruksion Sh.p.k. zotëron 49 (dyzet e nëntë) kuota, e barabartë me 49% (dyzet e nëntë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 6 – Rritja e kapitalit themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 6.2 Në rast rritje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me kuotën e zotëruar prej tyre. Në rast se njëri nga ortakët nuk e ushtron këtë të drejtë, pjesa e tij mund të nënshkruhet nga ortaku tjetër proporcionalisht me kuotat e zotëruara prej tij në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 7 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 7.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 7.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me kuotat e zotëruar prej tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 8 – Transferimi i kuotave

- 8.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 8.2 Transferimi i kuotave të Shoqërisë në kuptimin më të gjerë të fjalës, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të të tretëve, i nënshtrohet të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjetër. Ortaku i cili dëshiron të transferojë kuotën e tij do të njoftojë Ortakun Tjetër nëpërmjet një njoftimi me shkrim, i cili do të përmbajë edhe kushtet e transferimit.
- 8.3 Në rast se Ortaku Tjetër nuk dëshiron të blejë Kuotën e Ofruar, brenda 10 ditëve nga lajmërimi i dërguar nga Shitësi, Shitësi ka të drejtën e transferimit të Kuotës së Ofruar në favor të të tretëve.



A2021051080003510760

KAPITULLI III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

- 9.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese:
- (a) ndryshime të statutit të Shoqërisë;
 - (b) emërimin, shpërblimin, zëvendësimin dhe shkarkimin e administratorëve, ekspertëve kontabël, këshilltarëve të jashtëm dhe likuidatorët;
 - (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - (d) transferimin e kuotave;
 - (e) shpërndarjen e fitimeve;
 - (f) riorganizimin dhe prishjen, likuidimin ose mbylljen e Shoqërisë;
 - (g) shpërblimin e çdo ortaku ose administratori të Shoqërisë;
 - (h) miratimin e llogarive vjetore;
 - (i) miratimin e çdo vendimi që aprovon çdo transaksion ose huadhënie me ose midis Shoqërisë dhe çdo punonjësi, Administratori ose Ortaku të Shoqërisë;
 - (j) miratimin e transaksioneve bankare dhe/ose çdo veprim tjetër tregtare që do të tejkalojë vlerën prej 10,000 Euro (dhjetë mijë euro),
 - (k) ndryshimin lidhur me të drejtat e përfaqësimit lidhur me marrjen e detyrimeve nga ana e Shoqërisë;
 - (l) transferimin e të gjithë ose një pjese të konsiderueshme të pasurisë, biznesit apo pronësisë intelektuale të Shoqërisë;
 - (m) themelimin e shoqërive, nënshkrimin dhe shlyerjen e aksioneve dhe kuotave të kapitalit në shoqëri të tjera, në Shqipëri apo jashtë saj;
 - (n) marrjen e çdo vendimi që ndikon në ndonjë ndryshim thelbësor të aktivitetit të Shoqërisë;
 - (o) ndonjë bashkim të mundshëm me shoqëri të tjera;
 - (p) ndonjë transformim të mundshëm, likuidim apo falimentim të Shoqërisë; dhe
 - (q) çdo çështje tjetër të parashikuar nga Statuti.

Neni 10 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 10.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- 10.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër i pajisur me prokurë me shkrim, i cili jo domosdoshmërisht duhet të jetë ortak. Në çdo rast, prokura me shkrim do të jetë e vlefshme për një Asamble të Përgjithshme, si për thirrjen e parë ashtu edhe për thirrjen e dytë të saj.
- 10.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kuotave që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 11 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e inventarit dhe bilancit, të raportit të Administratorit, si dhe raportit të ekspertit kontabël (nëse është emëruar).
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori/ët ose prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret nëpërmjet njoftimit shkrim apo mesazh elektronik, që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që ata i kanë njoftuar Shoqërisë – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 11.3 Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen nga kryetari dhe t'u lejohet atyre të



A2021051080003510760

ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë aktivisht në të; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet njëkohësisht Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.

- 11.4 Asambleja e Përgjithshme do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar, dhe nëse ata janë dakord të marrin vendime pavarësisht parregullsisë së njoftimit.
- 11.5 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë të paktën 60% (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar. Në mungesë të kuorumit, asnjë çështje nuk do të trajtohet në mbledhje, dhe Asambleja e Përgjithshme do të shtyhet edhe për shtatë (7) ditë kalendarike; në vijim të saj, Mbledhja e Përgjithshme do të mbledhet përsëri në të njëjtin vend dhe në të njëjtën mënyrë si për Mbledhjen e Përgjithshme fillimisht të planifikuar.
- 11.6 Asambleja e Përgjithshme vendos për ndryshimet e statutit, rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë me votën pro të të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Në të gjitha rastet e tjera dhe kur nuk është përcaktuar ndryshe në Statut, Asambleja e Përgjithshme merr vendim me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm që përfaqësojnë të paktën 60% (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 11.7 Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Kryetari i caktuar ndërmjet ortakëve ose personave të tjerë të pranishëm. Asambleja e Përgjithshme emëron një Sekretar, i cili mban procesverbalin dhe që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 11.8 Vendimet dhe procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme do të mbahen në gjuhën shqipe.

Neni 12 – Administratori/ët

- 12.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) ose më shumë administratorë, të cilët mund të jenë edhe jo ortak, të emëruar, për një afat 5 (pesë) vjeçar, nga Asambleja e Përgjithshme. Në përfundim të këtij afati, Administratorët mund të rizgjidhen ose të shkarkohen.
- 12.2 Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta. Administratori/ët ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 12.3 Administratori/ët mund të emërojnë përfaqësues me prokurë speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 12.4 Administrator i shoqërisë emerohet:
- **Zj. Ana Lleshi**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 07.05.1981, pajisur me letërnjoftim nr. **036384557** dhe nr. personal **I15507055G**, me banim në Tiranë, Shqipëri. Përveç sa parashikohet në Ligjin. 9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në lidhje me kompetencat, Administratori do të nënshkruajë kontrata, kryejë transaksione bankare dhe/ose çdo veprim tjetër tregtar që do të tejkalojë vlerën prej **10,000 Euro (dhjetë mijë euro)**, pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 13 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 13.1 Në rast se kërkohet nga ligji, kontrolli i balanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do të kryhet nga eksperti kontabël i emëruar për një periudhë 1 (një) vjeçare me mundësinë për t'u rizgjedhur për një periudhë tjetër nga Asambleja e Përgjithshme.
- 13.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.



A2021051080003510760

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 14 – Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

- 14.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 14.2 Bilanci vjetor, llogaritë financiare, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 14.3 Dokumentat që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 15 – Fitimet

- 15.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat e zotëruara prej tyre. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, për qëllime të posaçme, krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme apo ajo mund të vendosë edhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, tërësisht apo pjesërisht.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 16 – Shpërndarja

- 16.1 Shoqëria mund të shpërndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme që përfaqëson 75% të kapitalit në rastet e parashikuara nga ligji.
- 16.2 Shoqëria nuk shpërndahet në rast të paaftësisë për të vepruar, vdekjes, likuidimit apo falimentimit të ortakëve.

Neni 17 – Likuidimi

- 17.1 Në rast të prishjes, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar të likuidimit mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 17.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme merr vendim lidhur me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
- 17.4 Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori/ët do t'i shpërndajnë fitimin që mbetet pas likuidimit ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

KAPITULLI VI TË TJERA

Neni 18 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, si edhe ato që mund të lindin midis ortakëve ose midis një apo disa ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 18.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



A2021051080003510760

Neni 19 – Gjuha


Ky Akt Themelimi dhe Statut është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Neni 20 – Dispozita të Fundit


Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi dhe Statut, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

Nënshkruar më 09.03.2021

ORTAKËT


Ana Lleshi
Blessed Investment Sh.p.k.




Ida Mezini
Matrix Konstruksion Sh.p.k.




Notere